

VENDIM
Nr. 229, datë 14.4.2021

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE NDËRMJET PROGRAMEVE
TË MIRATUARA NË BUXHETIN E VITIT 2021, PËR MINISTRINË E
SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2021, të miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) në programin buxhetor “Shërbimet e kujdesit parësor”, në kategorinë shpenzime korrente, të pakësohet fondi prej 140 000 000 (njëqind e dyzet milionë) lekësh;

b) në programin buxhetor “Shërbimet të shëndetit publik”, në kategorinë shpenzime korrente, të shtohet fondi prej 140 000 000 (njëqind e dyzet milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Instituti i Shëndetit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe